



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr. 1214/5 prot.,

Datë 31.08.2022

**V E N D I M**  
**Nr. 842/2022**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Joanid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 31.08.2022, mori në shqyrtim çështjen me,

**Objekt:** “Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Incomed” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetar*”, me Nr. REF-25306-04-14-2022, me objekt: **Loti 111 “Calcium gluconate**”, me fond limit 26.442.968 lekë (pa TVSh), zhvilluar me datë 19.05.2022 nga autoriteti kontraktor, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

“Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Incomed” SHPK në procedurën e mësipërme të prokurimit.”

**Ankimues:** “Florfarma” SHPK  
Rruga “Qazim Vathi”, Nr.72, Tiranë

**Autoriteti Kontraktor:** Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale  
Rruga e Kavajës, nr. 1001, Tiranë

**Subjekte të Interesuara:** Operatori ekonomik “Incomed” SHPK  
Zona kadastrale 2376, Nr. pasurie 103/17-ND dhe 103/17,  
Lalm, Vaqarr, Tiranë

**Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID - 19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

## **V ë r e n:**

### **I**

#### *Vlerësimi paraprak*

I.1. Vlera limit e përlllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e lartë monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të. Gjithashtu, KPP konstatoi, se ankesat e operatorit ekonomik janë paraqitur për të njëjtën procedurë prokurimi, ndaj edhe ankimet e tij duhet të bashkohen e të shqyrtohen në një gjykim të vetëm.

I.3. Ankimuesi, për ankesën e protokolluar pranë KPP më nr.1214 prot., datë 08.06.2022, nuk ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Ndërkohë për ankesën e protokolluar pranë KPP më nr.1375 prot., datë 28.06.2022, ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

## II

### *Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 19.04.2022 në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “*Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetar*”, me Nr. REF-25306-04-14-2022, me objekt: **Loti 111 “Calcium gluconate”**, me fond limit 26.442.968 lekë (pa TVSh), zhvilluar me datë 19.05.2022 nga autoriteti kontraktor, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

II.2. Në datën 04.06.2022 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

- |                     |                              |
|---------------------|------------------------------|
| 1. “Incomed” SHPK   | 17.411.008 lekë, kualifikuar |
| 2. “Florfarma” SHPK | 26.388.559 lekë, kualifikuar |

II.3. Gjithashtu, në datën 08.06.2022 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E), mbi rezultatet e ri-vlerësimit të procedurës së mësipërme të prokurimit, (e njëjta renditje si në vlerësimin e parë) si më poshtë:

- |                     |                              |
|---------------------|------------------------------|
| 1. “Incomed” SHPK   | 17.411.008 lekë, kualifikuar |
| 2. “Florfarma” SHPK | 26.388.559 lekë, kualifikuar |

II.4. Në datën 26.06.2022, autoriteti kontraktor ka publikuar njoftimin e fituesit për procedurën e prokurimit në sistemin elektronik të prokurimeve.

II.5. Në datën 07.06.2022, nëpërmjet Sistemit Elektronik të Ankesave, operatori ekonomik ankimues “Florfarma” SHPK ka paraqitur ankimin elektronik numër A/2022/2263, protokolluar në Komisionin e Prokurimit me nr.1214 prot., datë 08.06.2022, duke kërkuar skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Incomed” SHPK, pjesëmarrës në procedurën e prokurimit.

II.5.1. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për

procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit nr. prot 1214/2 datë 09.06.2022, lidhur me kriteret për të cilat operatori ekonomik ankimues “Florfarma” SHPK, pretendon se nuk përmbushen nga operatori ekonomik “Incomed” SHPK, pjesëmarrës në procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.6. Në datën 28.06.2022, nëpërmjet Sistemit Elektronik të Ankesave, operatori ekonomik ankimues “Florfarma” SHPK ka paraqitur ankimin elektronik numër A/2022/2310, protokolluar në Komisionin e Prokurimit me nr.1375 prot., datë 28.06.2022, duke kërkuar skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Incomed” SHPK, pjesëmarrës në procedurën e prokurimit.

II.6.1. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit nr. prot 1375/2 datë 29.06.2022, lidhur me kriteret për të cilat operatori ekonomik ankimues “Florfarma” SHPK, pretendon se nuk përmbushen nga operatori ekonomik “Incomed” SHPK, pjesëmarrës në procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.7. Në datën 27.07.2022, nëpërmjet shkresës nr. 1214/3 prot., me objekt: *“Mbi detyrimin e autoritetit kontraktor për dhënie informacioni KPP-së lidhur me ankesat e operatorit ekonomik “Florfarma” SHPK”*, me qëllim vijimin e gjyqimit të ankesave, Komisioni i Prokurimit Publik i kërkoi autoritetit kontraktor informacion të hollësishëm mbi procedurën e prokurimit objekt ankimi.

II.8. Me shkresën nr.1533/172 prot., datë 03.08.2022 me objekt: *“Dërgohet informacion shkresor mbi ankesat e OE “Florfarma” SHPK”*, protokolluar me tonën me nr. 1214/4 prot, datë 08.08.2022, autoriteti kontraktor ka dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, informacion mbi procedurën e prokurimit, si dhe vendimet e autoritetit kontraktor lidhur me trajtimin e ankesave të paraqitura nga operatori ekonomik “Florfarma” SHPK, ku rezulton, se autoriteti kontraktor i ka refuzuar ato.

II.9. Nga shqyrtimi i akteve të ndodhura në fashikullin e shqyrtimit administrativ rezulton, se operatori ekonomik i interesuar në këtë procedurë prokurimi “Incomed” SHPK, nuk ka dorëzuar argumente në përputhje me nenin 113 të LPP-së, në formë shkresore apo në sistemin e ankesave elektronike.

### III

Komisioni i Prokurimit Publik pas shqyrtimit të ankesave, dokumentacionit bashkëngjitur tyre, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

#### Arsyeton

III.1. Lidhur me ankimin elektronik numër A/2022/2263 datë 07.06.2022, protokolluar në Komisionin e Prokurimit me nr.1214 prot. datë 08.06.2022, të operatorit ekonomik ankimues “Florfarma” SHPK, Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se:

III.1.1. Në datën 19.04.2022 në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “*Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetar*”, me Nr. REF-25306-04-14-2022, me objekt: **Loti 111 “Calcium gluconate”**, me fond limit 26.442.968 lekë (pa TVSh), zhvilluar me datë 19.05.2022 nga autoriteti kontraktor, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

III.1.2. Në datën 04.06.2022 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

- |                     |                              |
|---------------------|------------------------------|
| 1. “Incomed” SHPK   | 17.411.008 lekë, kualifikuar |
| 2. “Florfarma” SHPK | 26.388.559 lekë, kualifikuar |

III.1.3. Gjithashtu, në datën 08.06.2022 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E), mbi rezultatet e rivlerësimit të procedurës së mësipërme të prokurimit, (e njëjta renditje si në vlerësimin e parë) si më poshtë:

- |                     |                              |
|---------------------|------------------------------|
| 1. “Incomed” SHPK   | 17.411.008 lekë, kualifikuar |
| 2. “Florfarma” SHPK | 26.388.559 lekë, kualifikuar |

III.1.4. Në datën 26.06.2022, autoriteti kontraktor ka publikuar njoftimin e fituesit për procedurën e prokurimit në sistemin elektronik të prokurimeve.

III.1.5. Në datën 07.06.2022, nëpërmjet Sistemit Elektronik të Ankesave, operatori ekonomik ankimues “Florfarma” SHPK ka paraqitur ankimin elektronik numër A/2022/2263, protokolluar në Komisionin e Prokurimit me nr.1214 prot., datë 08.06.2022, duke kërkuar skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Incomed” SHPK, pjesëmarrës në procedurën e prokurimit.

III.1.6. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit nr. prot 1214/2 datë 09.06.2022, lidhur me kriteret për të cilat operatori ekonomik ankimues “Florfarma” SHPK, pretendon se nuk përmbushen nga operatori ekonomik “Incomed” SHPK, pjesmarrës në procedurën e mësipërme të prokurimit.

III.1.7. Me shkresën nr.1533/172 prot., datë 03.08.2022 me objekt: “Dërgohet informacion shkresor mbi ankesat e OE “Florfarma” SHPK”, protokolluar me tonën me nr. 1214/4 prot, datë 08.08.2022, autoriteti kontraktor ka dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, informacion mbi procedurën e prokurimit, si dhe vendimet e autoritetit kontraktor lidhur me trajtimin e ankesave të paraqitur nga operatori ekonomik “Florfarma” SHPK, ku rezulton, se autoriteti kontraktor i ka refuzuar ato.

Konkretisht me anë të shkresës nr.1533/59 prot., datë 09.06.2022, konstatohet, se autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje ankesës së operatorit ekonomik “Florfarma” SHPK duke e refuzuar atë, me arsyetimin se është paraqitur përpara se të nisin afatet e ankimit.

III.1.8. Neni 24, pika 1, “Komisioni i prokurimit Publik” i Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon shprehimisht se: “Komisioni i Prokurimit Publik është organi më i lartë administrativ në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit dhe kryen çdo detyrë tjetër që i ngarkohet me këtë ligj dhe akte të tjera ligjore brenda fushës së kompetencave të tij.”.

III.1.9. Në nenin 110, pikat 2, 7 dhe 8 “Afatet për ankimit” të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon shprehimisht se: “2. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të fituesit ose publikimi i njoftimi të anulimit.

*Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë.*

*7. Në rast se operatori ekonomik nuk paraqet ankesën brenda afateve të parashikuara në këtë nen, atëherë nuk ka mundësi të ushtrojë më të drejtën e ankimit pranë autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.*

*8. Të shtunat, të dielat dhe ditët e festave zyrtare nuk pengojnë fillimin dhe kohëzgjatjen e afateve. Kur dita e fundit e një afati bie e shtunë, e diel ose një ditë feste zyrtare, afati mbaron në ditën e punës që vjen pas saj. Ankesa quhet e pranuar në ditën e depozitimit të saj pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.”.*

III.1.10. Në nenin 111, pika 1, të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se: “1. Operatori ekonomik ankimues dërgon njëkohësisht ankesën në autoritetin ose entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik. Rregulla të posaçme për mënyrën e paraqitjes së ankesës përcaktohen në rregullat e prokurimit publik.”.

III.1.11. Në nenin 97 pika 2, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet:

“2. Në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit/entit kontraktor:

a) brenda 10 (dhjetë) ditëve nga publikimi i njoftimit të fituesit, ose publikimi i njoftimi të anulimit, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar;

b) brenda 7 (shtatë) ditëve nga publikimi i njoftimit të fituesit, ose publikimi i njoftimi të anulimit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar.”

III.1.12. Neni 112, pikat 1 dhe 2 të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon shprehimisht se: “1. Me marrjen e ankesës, autoriteti ose enti kontraktor konfirmon në databazën e të dhënave të publikuara nga Komisioni i Prokurimit Publik që ankesa është paraqitur pranë këtij institucioni. Nëse autoriteti ose enti kontraktor konstaton se ankesa nuk është paraqitur në Komisionin e Prokurimit Publik, e refuzon atë si të pavlefshme.

2. Pasi konfirmon se ankesa është paraqitur në Komisionin e Prokurimit Publik, autoriteti ose enti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit deri në shqyrtimin plotësisht të ankesës, përfshirë edhe nxjerrjen e një vendimi nga Komisioni i Prokurimit Publik.”.

Në nenin 114, pikat 1 dhe 4, “Trajtimi i ankesës nga autoriteti ose enti kontraktor” të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se: “1. Në rastet e ankesave për dokumentet e tenderit, autoriteti ose enti kontraktor duhet të shprehet në lidhje me ankesën e paraqitur brenda 5 ditëve nga momenti i konfirmimit të regjistrimit të saj nga Komisioni i Prokurimit Publik.

Në rastet e ankesave për vendimin e përzgjedhjes së kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, autoriteti ose enti kontraktor duhet të shprehet për ankesën e paraqitur brenda 5 ditëve nga përfundimi i afatit kohor në dispozicion të operatorëve ekonomikë të interesuar, sipas parashikimeve në nenin 113 të këtij ligji, për paraqitjen e argumenteve të tyre.

“4. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor vë në dijeni për vendimin e marrë Komisionin e Prokurimit Publik, ankuesin, operatorët ekonomikë të interesuar brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi, duke e shoqëruar me shpjegimet dhe dokumentacionin përkatës.”.

Neni 118, “Vendimet e Komisionit të Prokurimit Publik” i Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon shprehimisht se: “1. Komisioni i Prokurimit Publik, në çdo kohë pas marrjes së ankesës dhe para lidhjes së kontratës, kur nuk vendos pezullimin, mund ta lejojë autoritetin ose entin kontraktor, me anë të një vendimi të ndërmjetëm deri në marrjen e një vendimi përfundimtar, të vazhdojë procedurën e prokurimit nëse pezullimi dëmton tërthorazi interesin publik, autoritetin ose entin kontraktor ose ofertuesit.

2. Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik ka të drejtë:

a) të refuzojë ankesën, për shkak të mosplotësimit të elementeve të domosdoshme për shqyrtimin e saj, sipas parashikimeve të nenit 111 të këtij ligji;

b) të pranojë ankesën dhe të urdhërojë autoritetin ose entin kontraktor të anulojë plotësisht ose pjesërisht një veprim ose vendim, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin;

c) të refuzojë ankesën dhe të lejojë autoritetin ose entin kontraktor të vazhdojë procedurën e prokurimit, kur gjykon se nuk ka shkelje të dispozitave ligjore;

ç) të nxjerrë vendim deklarativ për mbylljen e çështjes, sipas parashikimeve të pikave 2 dhe 3 të nenit 115 të këtij ligji;

d) të refuzojë ankesën, e cila ka si objekt kundërshtimin e një vendimi të dhënë nga Komisioni i Prokurimit Publik, në rast të një ankese tjetër që i përket të njëjtës procedurë, të paraqitur nga i njëjti operator ekonomik”.

III.1.13. Referuar bazës ligjore të sipërcituar, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se afati për dorëzimin e ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për kundërshtimin e vendimit të KVO-së lidhur me vlerësimin/klasifikimin përfundimtar, është 10 ditë nga publikimi i njoftimit të fituesit ose i njoftimit të anulimit. Në rastin konkret referuar verifikimeve në Sistemin e Prokurimit Elektronik, si dhe informacionit të dërguar nga ana e autoritetit kontraktor, u konstatua, se në momentin e paraqitjes së ankesës nga operatori ekonomik ankimues në datë 07.06.2022, protokolluar në 08.06.2022, nga ana e autoritetit kontraktor ende nuk ishte publikuar njoftimi i fituesit.

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se operatori ekonomik ankimues ka dorëzuar ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik përpara afatit të parashikuar nga neni 110, pika 2 e Ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik”, i cili parashikon se “2. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimin/klasifikimit përfundimtar, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të fituesit ose publikimi i njoftimit të anulimit. Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë.”, pasi në datën 07.06.2022, protokolluar në 08.06.2022, nga ana e autoritetit kontraktor nuk është publikuar akoma njoftimi i fituesit të procedurës së prokurimit objekt-ankimimi.

Referuar parashikimeve të sipërcituara, llogaritja e afatit për ankim pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, kundër vendimeve të autoritetit kontraktor lidhur me vlerësimin e procedurës së prokurimit, për procedurat mbi kufirin e lartë monetar, nis ditën e publikimit të njoftimit të fituesit dhe përfundon në ditën e 10-të. Në rastin konkret, në datën 07.06.2022/08.06.2022, afati i paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe njëkohësisht pranë Komisionit të Prokurimit Publik nuk kishte filluar akoma për sa kohë nuk ishte publikuar njoftimi i fituesit të procedurës së prokurimit, që do të thotë se ankimuesit nuk i kishte lindur akoma e drejta e ankimit.

Për sa më sipër, ankesa e operatorit ekonomik ankimues “Florfarma” SHPK, e depozituar nëpërmjet Sistemit Elektronik të Ankesave, datë 07.06.2022 numër A/2022/2263, protokolluar në Komisionin e Prokurimit me nr.1214 prot., datë 08.06.2022, konsiderohet e paraqitur përpara afatit ligjor të ankimit, duke mos u legjitimuar *ratione temporis*. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se ligji *stricto sensu* ka parashikuar, se ankesa dorëzohet njëherazi si pranë autoritetit ose entit kontraktor ashtu edhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe është përgjegjësi e operatorit



ekonomik ankimues, që ta dorëzojë këtë të fundit njëherazi në të dyja institucionet, brenda afatit të parashikuar në ligj.

III.1.14. Sa më sipër arsyetuar, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se ankesa e dorëzuar nga operatori ekonomik ankimues, nuk ka përmbushur detyrimin për ndjekjen e afateve ligjore të ankimimit, ndaj përbën shkak për mospranimin e ankesës nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik. Komisioni i Prokurimit Publik rithekson bindjen e tij, se për shkak të specifikës së prokurimeve publike, respektimi i afateve, është i një rëndësie thelbësore e me ndikim të drejtpërdrejtë në efikasitetin e procedurës, ndaj edhe i qëndron strikt rregullit të parashikuar nga ligji i prokurimit publik si *lex specialis* mbi lëndën.

III.2. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Florfarma” SHPK në ankimin elektronik numër A/2022/2310, protokolluar në Komisionin e Prokurimit me nr.1375 prot. datë 28.06.2022, për skualifikimin e operatorit ekonomik “Incomed” SHPK, me arsyetimin se “...Nisur nga specifikimet teknike të kërkuara për lotin Nr.111 Calcium gluconate 1 gr/10 ml – 10 ml Flakon/Ampulë, na rezulton se produkti i shpallur i suksesshëm në SPE e APP (<https://ëëë.app.gov.al/njoftimi-i-fituesit/>) nuk është i njëjtë me atë të kërkuar në DST, kjo për faktin se produkti i kompanisë OSEL ILAC SAN.VE TIC.A.S – TURQI përmban 225mg/10 ml Calcium Gluconate ndërkohë që në specifikimet teknike të tenderit është kërkuar Calcium Gluconate 1 gr/10 ml – 10 ml Flakon/Ampulë pra duhet 1g/10 ml (ose 1000 mg/10 ml) Calcium Gluconat, kërkesë të cilën e plotëson produkti i prodhuar nga kompania “Profarma Sh.a” për të cilën edhe kompania jonë ka paraqitur ofertë sipas autorizimit të lëshuar nga kjo kompani. Për këtë konstatim kompania jonë është bazuar në listën e barnave të pajisura me autorizim për tregëtim në Republikën e Shqipërisë të publikuar nga Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore në faqen zyrtare të internetit [akbpm@shëndetësia.gov.al](mailto:akbpm@shëndetësia.gov.al).”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.2.1. Në dokumentet e tenderit, te Njoftimi i kontratës, seksionin 2, pika 2.10 “Përshkrimi i shkurtër i kontratës / Marrëveshjes Kuadër”, për Lotin 111, objekt-ankimi, autoriteti kontraktor ka parashikuar:

Nr.	Sistemi	Lot/Principi aktiv	Formë - doza	Njësia	Sasi e planifikuar per 24 Muaj	Fondi limit	Fondi limit
						24 muaj (vlera e pritshme e kontratave) Lek pa TVSH /lot	24 muaj (vlera e pritshme e kontratave) ne Euro
111	Metabolizmi dhe trakti tretes	Lot 111 Calcium gluconate	1 gr/10 ml - 10 ml	Flakon/ Ampule	544,094	26,442,968	218,483



Levulinat kalciumi dihidrat 572mg/10ml

- Mbajtësi i Autorizimit për Tregtim: HAVER FARMA ILAC A.S., Acarlar Mah. 74. Sok. Acarkent Sitesi B742 No.:17/1, Beykoz, Istanbul, Turqi
  - Prodhuesi (t): OSEL ILAC SAN. VE TIC. A.S., Akbaba Mah. Maras Caddesi No:52 Beykoz, Istanbul, Turqi.
- Letër Autorizimi datë 26.04.2022 lëshuar nga HAVER FARMA ILAC A.S për operatorin ekonomik “Incomed” SHPK.

III.2.4. Në nenin 77, pika 1 dhe 4 “Kërkesat për kualifikim” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikon shprehimisht se:

1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

[...]

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”.

III.2.5. Në nenin 36 të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikohet shprehimisht se:

“Specifikimet teknike, siç përcaktohen në nenin 4 të këtij ligji, duhet të përshkruhen në dokumentet e tenderit. Në specifikimet teknike përcaktohen qartë karakteristikat e punëve, shërbimit ose furnizimit që do të prokurohet.

Këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj.

Në specifikimet teknike mund të specifikohet edhe nëse do të jetë i nevojshëm transferimi i të drejtave të pronësisë intelektuale.

*Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuar ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi.*

*2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.*

*3. Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor, duke iu referuar:*

*a) kërkesave funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t'u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën;*

*b) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve;*

*c) kërkesave në terma funksionalë sipas shkronjës "a", referuar specifikimeve teknike sipas shkronjës "b" të kësaj pike, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale;*

*ç) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat "a" dhe "b" të pikës 3 të këtij neni, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët "ose ekuivalenti i tij/saj".*

*4. Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të këtij neni. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët "ose ekuivalente".*

*5. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës "b" të pikës 3 të këtij neni, nuk mund të refuzojë një ofertë me argumentin se punët, furnizimet apo shërbimet për të cilat është dorëzuar oferta nuk plotësojnë specifikimet teknike, të cilave u referohen, për sa kohë që ofertuesi provon në ofertën e tij me çdo mjet të përshtatshëm që zgjidhjet e propozuara përmbushin kërkesat e përcaktuara në specifikimet teknike në mënyrë ekuivalente.*

*6. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës "a" të pikës 3 të këtij neni, ai nuk mund të refuzojë një ofertë për punë, mallra apo shërbime, e cila është në përputhje me standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimet teknike ndërkombëtare, specifikimet teknike të përgjithshme, standardet ndërkombëtare apo sistemet e tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit kur këto specifikime teknike përmbushin kriteret funksionale, të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor."*

III.2.6. Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë se operatorët ekonomikë duhej të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato.

III.2.7. Autoriteti kontraktor në aktin e trajtimit të ankesës së operatorit ekonomik ankimes ka argumentuar *“Referuar të dhënave të barit, bazuar në regjistrin e barnave, rezulton se bari CALCIOSEL 10% Solution for injection x (225mg + 572mg)/10, me mbajtës autorizimi për tregëtim "Haver Farma Ilac A.S. – Turqi” i pajisur me Autorizim Tregëtimi me urdhrin nr.239, datë 07.04.2020 ka në përbërje të tij kombinimin e lëndëve, Calcium gluconate monohydrate + Calcium levulinate dihydrate, të cilat janë forma të kriprave të Calciumit dhe sasia e calciumit elementar e cila clirohet në organizëm pas administrimit të barit është e njëjtë me formëdozën e kërkuar në DST. Për sa më sipër pretendimi juaj nuk pranohet.”*

III.2.8. Nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-shqyrtimi, KPP vëren, se autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit për Lotin 111 ka përcaktuar principin aktiv “Calcium gluconate”, me formë dozë 1 gr/10 ml - 10 ml, njësia Flakon/Ampulë. Ndërkohë në shtojcën 5 “Formulari i specifikimeve teknike”, ndër të tjera ka përcaktuar se *“Formë – doza, njësia dhe volumi për secilin bar është përcaktuar në DST dhe është detyruese.”*

III.2.9. Referuar sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik, nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik “Incomed” SHPK, konstaton, se ky i fundit, për të plotësuar kriterin e mësipërm ka paraqitur dokumentin “Autorizim për Tregëtim Nr.1381/23 prot., datë 05.08.2020, lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore, ku përcaktohet emri, formë/doza farmaceutike e barit: CALCIOSEL 10 % - Tretësirë për injeksion, (225mg + 572mg) /10ml; Përbërësi (t) aktiv (ë): Glukonat kalciumi monohidrat - 225mg/10ml, Levulinat kalciumi dihidrat 572mg/10ml; Mbajtësi i Autorizimit për Tregëtim: HAVER FARMA ILAC A.S., Acarlar Mah. 74. Sok. Acarkent Sitesi B742 No.:17/1, Beykoz, Istanbul, Turqi si dhe Prodhuësi (t): OSEL ILAC SAN. VE TIC. A.S., Akbaba Mah. Maras Caddesi No:52 Beykoz, Istanbul, Turqi. Gjithashtu, operatori ekonomik ka paraqitur shkresën nr. 3442/1 prot., datë 16.05.2022 me objekt “Kthim përgjigje”, lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore, drejtuar “Incomed” SHPK, ku bashkëlidhur gjendet lista e barnave që janë të pajisur me Autorizim për Tregëtim në Republikën e Shqipërisë, ku nga verifikimi i kësaj liste konstatohet se gjendet edhe bari CALCIOSEL 10%, Solution for injection (225mg + 572mg) /10ml; Calcium Gluconate

Monohydrate + Calcium Levulinate Dihydrate, Box x 5 ampoules x 10 ml; me mbajtës autorizimi Haver Farma Ilac A.S – Turqi dhe prodhues OSEL ILAC SAN. VE TIC. A.S. Turqi.

Operatori ekonomik ka dorëzuar gjithashtu në SPE dokumentin Letër Autorizimi datë 26.04.2022 lëshuar nga HAVER FARMA ILAC A.S për operatorin ekonomik “Incomed” SHPK.

Sa më sipër, nisur nga pretendimet e operatorit ekonomik ankimes, shqyrtimi i dokumentave të tenderit, si dhe verifikimi i dokumentacionit të paraqitur në SPE nga operatori ekonomik “Incomed” SHPK, konstatohet se autoriteti kontraktor ka kërkuar që për Lotin 111 ka përcaktuar principin aktiv “Calcium gluconate”, me formë dozë 1 gr/10 ml - 10 ml, gjithashtu në specifikimet teknike përcaktohet që formë – doza, njësia dhe volumi për secilin bar është përcaktuar në DST dhe është detyruese, ndërkohë, që nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik “Incomed” SHPK, konstatohet, se ky i fundit ka ofruar produktin (barin) CALCIOSEL 10 % - Tretësirë për injeksion, (225mg + 572mg) /10ml, me përbërës (t) aktiv (ë): Glukonat kalciumi monohidrat - 225mg/10ml dhe Levulinat kalciumi dihidrat - 572mg/10ml. Pra, bari i ofruar nga operatori ekonomik “Incomed” SHPK nuk është në të njëjtën formë dozë siç kërkohet nga autoriteti kontraktor (1 gr/10 ml - 10 ml). Akoma më tej vlen të theksojmë, se për Lotin 111 kërkohet ofrimi i produktit “Calcium gluconate”, ndërkohë operatori ekonomik “Incomed” SHPK ka ofruar produktin (barin) CALCIOSEL 10 % - Tretësirë për injeksion, (225mg + 572mg) /10ml, me dy përbërës Glukonat kalciumi monohidrat - 225mg/10ml dhe Levulinat kalciumi dihidrat - 572mg/10ml.

Sa më sipër argumentuar, konstatohet, se specifikimet teknike të produktit të ofruar nga operatori ekonomik “Incomed” SHPK, nuk përputhen me specifikimet teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor për këtë produkte, duke mos plotësuar kështu kërkesat e autoritetit kontraktor.

Vlen të theksojmë, se bazuar në nenin 82 pika 1 të ligjit 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i RSH”, barra e provës për të vërtetuar plotësimin e kërkesave të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, bie mbi operatorin ekonomik, i cili në rastin konkret ka dështuar ta vërtetojë atë.

III.2.10. Sa më sipër KPP gjykon, se në rast se operatori ekonomik “Incomed” SHPK do të kishte pretendime në lidhje me kërkesat e mësipërme të autoritetit kontraktor, ka pasur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së ankesës mbi hartimin e dokumenteve dhe kriterëve të veçanta të kualifikimit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, parashikuar nga neni 110 pika 1 e ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, ku parashikohet se “Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të kontratës ose publikimi i ndryshimit të kërkesave në dokumentet e tenderit. Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë”.

Gjithashtu, kuadri ligjor parashikon një sërë elementesh si garanci për operatorët ekonomikë të cilët kanë paqartësi në lidhje me interpretimin e kërkesave të autoritetit kontraktor dhe/ose mënyrës së plotësimit të kriterëve kualifikuese. Në rast se operatori ekonomik do të kishte paqartësi në lidhje me plotësimin e kërkesës së mësipërme, ka pasur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së kërkesës për sqarime pranë autoritetit kontraktor jo më vonë se 6 ditë para afatit

përfundimtar të dorëzimit të ofertave parashikuar nga neni 75 i LPP-së. Në nenin 75, pika 1 të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet se “[...]Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti ose enti kontraktor, i cili duhet t’i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 6 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. Autoriteti kontraktor ose enti duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t’ua komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit. [...]”.

Rrjedhimisht, pretendimet e operatorit ekonomik “Florfarma” SHPK qëndrojnë.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30 dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 261, datë 17.03.2010 “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, me shumicë,

#### Vendos:

1. Të mos pranojë ankesën nr.1214 prot., datë 08.06.2022 të operatorit ekonomik “Florfarma” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-25306-04-14-2022, me objekt: **Loti 111 “Calcium gluconate”**, me fond limit 26.442.968 lekë (pa TVSh), zhvilluar me datë 19.05.2022 nga autoriteti kontraktor, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.
2. Të pranojë ankesën nr.1375 prot., datë 28.06.2022 të operatorit ekonomik “Florfarma” SHPK për procedurën e mësipërme të prokurimit.
3. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së për kualifikimin e operatorit ekonomik “Incomed” SHPK, si dhe të korrigjojë shkeljet e konstatuara si më sipër, duke e skualifikuar këtë operator ekonomik.
4. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi duke dokumentuar veprimet e kryera.

5. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Florfarma” SHPK për ankesën nr.1214 prot., datë 08.06.2022.
  6. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Florfarma” SHPK për ankesën nr.1375 prot., datë 28.06.2022.
  7. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
  8. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Nënkryetar**  
**Fiorent Zguro**

**Anëtar**  
**Kreshnik Ternova**

**Anëtar**  
**Anila Malaj**

**Kryetar**  
**Jonaid Myzyri**





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Mendim Paralel**

Unë anëtar i Komisionit të Prokurimit Publik, Kreshnik Ternova, jap mendimin tim paralel në lidhje me procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetar*”, me Nr. REF-25306-04-14-2022, me objekt: **Loti 111 “Calcium gluconate”**, me fond limit 26.442.968 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 19.05.2022 nga autoriteti kontraktor, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, për sa i përket ankimit elektronik numër A/2022/2310, protokolluar në Komisionin e Prokurimit me nr.1375 prot., datë 28.06.2022, të operatorit ekonomik “Florfarma” SHPK.

Pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumenteve të dërguara nga autoriteti kontraktor,

**Arsyetoj:**

Në përgjigje të ankimit elektronik me nr. A/2022/2310 dhe me nr. 1375/2022 prot. nga operatori ekonomik “Florfarma” SHPK, për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetar*”, me Nr. REF-25306-04-14-2022, me objekt: “*B2-Blerje barna Antineoplastike dhe immunomodulatore, Barna antiparazitare, Barna hormonale sistemike, hormonet seksuale, Gjaku dhe organet formuese te gjakut, Lëndë kontrasti për CT, Lëndë kontrasti për MRI, Lëndë Kontrasti gastrointestinale, Metabolizmi dhe trakti tretës dhe Barna dermatologjike*”, ndarë në 128 lote - *Loti 111. Calcium gluconate 1g/10ml-10ml, Flakon/Ampulë*, me fond limit 26.442.968 lekë (pa TVSh), zhvilluar me datë 19.05.2022 nga autoriteti kontraktor, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, dhe në përgjigje të shkresës së kësaj të fundit nr. 1533/172 prot., datë 03.08.2022, si dhe aktit të trajtimit të ankeseës nga Autoriteti Kontraktor nr. 1533/147 datë 08.07.2022 konstatojmë si më poshtë vijon:

Referuar specifikimeve teknike të hartuara nga autoriteti kontraktor dhe njëherazi pjesë e Dokumenteve Standarde të Tenderit (në vijim DST) për këtë procedurë prokurimi, Loti 111 përmban këto të specifikime teknike: *Calcium gluconate 1g/10ml-10ml, Flakon/Ampulë*. Ndërkohë, rezulton, se për këtë lot, është vlerësuar si i suksesshëm bari CALCIOSEL (Calcium gluconate monohydrate 225mg + Calcium levulinate dihydrate 572mg, Solucion për injeksion, Ampulë x 10 ml).

Parë në këndvështrimin teknik, bari CALCIOSEL, me principe aktivë: Calcium gluconate monohydrate 225mg dhe Calcium levulinate dihydrate 572mg, dhe formë farmaceutike: Solucion për injeksion, Ampulë x 10 ml, nuk plotëson specifikimet teknike të Lotit 111. *Calcium gluconate 1g/10ml-10ml, Flakon/Ampulë*, si për sa i takon principit aktiv (përbërja cilësore), ashtu edhe dozës farmaceutike (përbërja sasiore). Kjo pasi loti në fjalë i paraqitur në DST-në e hartuar nga autoriteti kontraktor, ka si princip aktiv vetëm *Calcium gluconate* dhe jo kombinim të kripërave të ndryshme të kalciumit, sikurse janë *Calcium gluconate* dhe *Calcium levulinate*, përkatësisht në trajtë monohydrate dhe dihydrate. Gjithashtu, doza e barit me emër tregtar CALCIOSEL, dukshëm nuk përputhet me dozën 1g/10ml të Lotit 111, sikurse specifikohet në DST.

Për sa i takon zbatimit të procedurës, Ligji Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe VKM Nr. Nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, përcaktojnë si detyrim për autoritetin kontraktor, hartimin dhe argumentimin e specifikimeve teknike të përdorura në procedurën e prokurimit. Ndonëse autoriteti kontraktor ka parashikuar vetëm si vijon: *Loti. 111. Calcium gluconate 1g/10ml-10ml, Flakon/Ampulë*, rezulton, se gjatë vlerësimit të ofertave, ky autoritet nuk ka respektuar specifikimet teknike të hartuara dhe argumentuara prej tij, duke kundërshtuar veten.

Referuar kuadrit ligjor të sipërcituar, oferta fituese është ajo e cila, bazuar në kërkesat dhe kriteret e përcaktuara në DST, plotëson kërkesat e objektit të prokurimit. Në vijim të kësaj të fundit, dhe duke iu referuar rastit në fjalë, oferta fituese duhet të plotësojë si kriterin cilësor ashtu edhe atë sasior të specifikimeve teknike: *Calcium gluconate 1g/10ml-10ml, Flakon/Ampulë*.

Për të argumentuar vendimin e marrë nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave (në vijim KVO), autoriteti kontraktor midis të tjerash citon: “...*sasia e kalciumit elementar* e cila çlirohet në organizëm pas administrimit të barit është e njëjtë me formdozën e kërkuar në DST”. Ky argumentim mbi vetitë farmakologjike të barit, për të cilin nuk citohet asnjë literaturë referente, dhe jokorrekt për nga përmbajtja, është jashtë objektit të specifikimeve teknike të paraqitura në DST, ku sasia e kalciumit elementar të çliruar në organizëm nuk përmendet si i tillë (specifikim teknik). Duke ndjekur logjikën e argumentit të paraqitur nga autoriteti kontraktor, sasia e kalciumit elementar të çliruar në organizëm pas administrimit të barit CALCIOSEL duhet të ishte 1g për 10ml (e njëjtë me formdozën e kërkuar në DST), ose 10.7 herë më e lartë se sasia e kalciumit elementar që ndodhet në një ampulë *Calcium gluconate 1g/10ml-10ml*.

Sa më sipër, të krijohet bindja e arsyeshme që autoriteti kontraktor nuk është ende i qartë mbi specifikimet teknike për Lotin 111. Kjo pasi ky autoritet, kërkon të justifikojë vendimin e marrë nga KVO-ja me një argument përtej specifikimeve teknike të miratuar prej tij dhe aspak korrekt në thelb (sasia e kalciumit elementar në organizëm mund të krahasohet me sasinë e kalciumit elementar të ndodhur në dozën përkatëse të barit në trajtë kripe, por kurrsesi të ekuivalentohet me formëdozën e barit).

Në kushtet aktuale, duke iu referuar DST-së së procedurës së prokurimit nr. REF-25306-04-14-2022, Ligjit Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe VKM-së Nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, rezulton, se në vlerësimin e bërë nga KVO-ja, **nuk janë respektuar specifikimet e hartuara dhe miratuara për Lotin III. Calcium gluconate 1g/10ml-10ml.**

**Pra pretendimet e OE qendrojnë.**

**Anëtari**

**Kreshnik Ternova**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**MENDIM KUNDËR**

Mendim kundër i Kryetarit të Komisionit të Prokurimit Publik z. Jonaid Myzyri në lidhje me vendimin e shumicës.

Si Kryetar i Komisionit të Prokurimit Publik shpreh mendimin kundër për sa i përket arsytimit të vendimit të shumicës mbi themelin e çështjes dhe rrjedhimisht dhe të dispozitivit të tij, për sa i përket ankimit elektronik numër A/2022/2310, protokolluar në Komisionin e Prokurimit me nr.1375 prot. datë 28.06.2022, të paraqitur nga operatori ekonomik “Florfarma” SHPK për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetar*”, me Nr. REF-25306-04-14-2022, me objekt: **Loti 111 “Calcium gluconate”**, me fond limit 26.442.968 lekë (pa TVSh), zhvilluar me datë 19.05.2022 nga autoriteti kontraktor, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumenteve të dërguara nga autoriteti kontraktor,

**Arsyetoj**

I.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Florfarma” SHPK në ankimin elektronik numër A/2022/2310, protokolluar në Komisionin e Prokurimit me nr.1375 prot. datë 28.06.2022, për skualifikimin e operatorit ekonomik “Incomed” SHPK, me arsytimin se “...Nisur nga specifikimet teknike të kërkuara për lotin Nr.111 Calcium gluconate 1 gr/10 ml – 10 ml Flakon/Ampulë, na rezulton se produkti i shpallur i suksesshëm në SPE e APP (<https://ëëë.app.gov.al/njoftimi-i-fituesit/>) nuk është i njëjtë me atë të kërkuar në DST, kjo për faktin se produkti i kompanisë OSEL ILAC SAN.VE TIC.A.S – TURQI përmban 225mg/10 ml Calcium Gluconate ndërkohë që në specifikimet teknike të tenderit është kërkuar Calcium Gluconate 1 gr/10 ml – 10 ml Flakon/Ampulë pra duhet 1g/10 ml (ose 1000 mg/10 ml) Calcium Gluconat, kërkesë të cilën e plotëson produkti i prodhuar nga kompania “Profarma Sh.a” për të cilën edhe kompania jonë ka paraqitur ofertë sipas autorizimit të lëshuar nga kjo kompani. Për këtë konstatim kompania jonë është bazuar në listën e barnave të pajisura me autorizim për

*tregëtim në Republikën e Shqipërisë të publikuar nga Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore në faqen zyrtare të internetit [akbpm@shendetesia.gov.al](mailto:akbpm@shendetesia.gov.al).”, vërej se,*

I.2. Lidhur me këtë pretendim të operatorit ekonomik ankimues shumica e anëtarëve të Komisionit të Prokurimit Publik është shprehur për pranimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues me argumentin se bari i ofruar nga operatori ekonomik “Incomed” SHPK nuk përmbush formë dozën e përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit.

Nga shqyrtimi i informacionit të paraqitur nga autoriteti kontraktor, konstatohet, se ky i fundit me shkresën nr. 1533/147 prot., datë 08.07.2022, ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik “Florfarma” SHPK duke e refuzuar atë me argumentin se *“Referuar të dhënave të barit, bazuar në regjistrin e barnave, rezulton se bari CALCIOSEL 10% Solution for injection x (225mg + 572mg)/10, me mbajtës autorizimi për tregëtim “Haver Farma Ilac A.S. – Turqi” i pajisur me Autorizim Tregtimi me urdhrin nr.239, datë 07.04.2020 ka në përbërje të tij kombinimin e lëndëve, Calcium gluconate monohydrate + Calcium levulinate dihydrate, të cilat janë forma të kriprave të Calciumit dhe sasia e calciumit elementar e cila clirohet në organizëm pas administrimit të barit është e njëjtë me formëdozën e kërkuar në DST. Për sa më sipër pretendimi juaj nuk pranohet.”*

Sa më sipër, gjykoj, se procedura e prokurimit është organizuar nga autoriteti kontraktor Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale e cila, referuar akteve nënligjore në fuqi ka një përgjegjësi dyfishe, atë të *“d) Hartimin dhe përditësimin e të gjitha protokolleve të mjekimit sipas praktikave bashkëkohore; dh) Zhvillimin e politikave që synojnë mbrojtjen, promovimin, integrimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të mirëqenies sociale të individëve, familjeve dhe komuniteteve në nevojë;”* referuar Vendimit Nr. 508, datë 13.09.2017 të Këshillit të Ministrave *“Për Përcaktimin e Fushës së Përgjegjësisë Shtetërore Të Ministrisë Së Shëndetësisë Dhe Mbrojtjes Sociale”* si edhe në cilësinë e Organit Qendror Blerës për kryerjen e procedurave të prokurimit, në emër dhe për llogari të spitaleve publike në varësi të saj, për blerjen e medikamenteve dhe materialeve mjekësore, në përputhje me Vendimin nr.135 datë 20.2.2013 të Këshillit të Ministrave *“Për Lejimin e Ministrisë Së Shëndetësisë për Kryerjen E Procedurave Të Prokurimit Publik, Në Emër Dhe Për Llogari Të Institucioneve Të Varësisë, Për Disa Mallra E Shërbime”*, ku ndër detyrat e tjera në cilësinë e organit qendror blerës ka edhe të *ç) të shqyrtojë dhe të miratojë specifikimet teknike, të dërguara nga autoritetet kontraktore. Nëse gjykohet se specifikimet teknike nuk janë përgatitur në përputhje me ligjin për prokurimet publike ose mund të shkaktojnë dështim të procedurës së prokurimit, organi qendror blerës kryen rishikimin e specifikimeve teknike, në bashkëpunim me specialistët e fushave, të institucioneve përgjegjëse ose specialistë të jashtëm, vendas a të huaj. Në këto raste, organi qendror blerës vë në dijeni autoritetet kontraktore për ndryshimet e bëra;*

*d) të unifikojë specifikimet teknike për mallra dhe shërbime të të njëjtit lloj, në përputhje me standardet e miratuara, në bashkëpunim me specialistët e fushave, të institucioneve përgjegjëse ose specialistë të jashtëm, vendas a të huaj. Në këto raste, organi qendror blerës vë në dijeni autoritetet kontraktore për ndryshimet e bëra;*

Theksoj faktin, se roli i paraparë nga ligjvënësi për Komisionin e Prokurimit Publik është ai një *quasi gjykate*, garant i zbatimit të ligjit për prokurimin publik dhe veçanërisht të parimit të transparencës dhe barazisë në trajtimin e kërkesave dhe detyrimeve ndaj palëve.

Nisur nga pretendimet e operatorit ekonomik ankimues, akti i trajtimit të ankesës nga ana e autoritetit kontraktor, si dhe vendimit të shumicës së Komisionit të Prokurimit Publik, konstatohet, se në themel të konfliktit administrativ qëndron fakti nëse bari i ofruar nga operatori ekonomik “Incomed” SHPK është i njëjtë me atë të kërkuar nga autoriteti kontraktor.

Gjithashtu, referuar dokumentacionit të administruar në fashikullin e shqyrtimit administrativ, rezulton, se si në Komisionin e Vlerësimit të Ofertave, ashtu edhe në Komisionin e Shqyrtimit të Ankesave, një nga anëtarët të cilët kanë shqyrtuar dhe krahasuar ofertat dhe shqyrtuar ankesën kanë qenë specialistë të fushës. Nga ana e autoritetit kontraktor është vlerësuar, se në nivel teknik kemi të bëjmë me të njëjtin bar, me të njëjtat karakteristika me ato të kërkuara nga ana ky i fundit.

Për këtë arsye, për të garantuar nivelin më të lartë të mbrotjes së interesit të ligjshëm të palëve në proces, gjykoj, se për sqarimin e fakteve kërkohet njohuri e posacme teknike, ndaj dhe duhej të ishte marrë në konsideratë mendimi i një eksperti të pavarur, i cili të mos ishte i përfshirë në zhvillimin e procedurës së prokurimit.

Konkretisht, vlerësoj, se për një shqyrtim të drejtë të ankesës, duhet të ishin ndjekur të gjitha elementet procedurale të kërkimit të provës, për aq sa parashikohet në Kodin e Procedurave Administrative, si edhe në *lex specialis* në rregullat për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik të miratuar me Vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”.

Në nenin 80 të ligjit nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative” parashikohet se: “*Me qëllim përcaktimin e gjendjes së fakteve dhe rrethanave që kanë lidhje me çështjen, organi publik mund: a) të mbledhë deklaratat nga palët, dëshmitarët dhe ekspertë; b) të marrë dokumente dhe dokumente të tjera të dokumentuara nëpërmjet mjeteve fotografike, të regjistrimit ose mjeteve të tjera teknike; c) të vizitojë dhe të kontrollojë mallrat apo vende të përfshira.*”

Gjithashtu, në nenin 115 pika 5 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” parashikohet se, “*Në rastin kur për shqyrtimin e ankesës Komisioni i Prokurimit Publik ka nevojë të kërkojë ekspertizë nga palë të treta ose të kryejë verifikime pranë organeve të tjera, afati i përcaktuar në pikën 4 të këtij neni ndërpritet dhe rifillon pasi të ketë siguruar informacionin e kërkuar. Afati për marrjen e vendimit nuk duhet të tejkalojë 30 ditë. Në çdo rast Komisioni i Prokurimit Publik ka detyrimin të vërë në dijeni palët.*”

Kështu, vlerësoj, se para vendimit përfundimtar, duhet të ishte zhvilluar një seancë dëgjimore, me përfaqësuesit e palëve, si dhe një ekspert, i cili të mos ishte i përfshirë në vendimmarrjen e procedurës së prokurimit objekt-ankimi, duke kërkuar sqarime, se a kryen bari me emër (CALCIOSEL 10 % - Tretësirë për injeksion, (225mg + 572mg) /10ml, me përbërës aktivë Glukonat kalciumi monohidrat - 225mg/10ml dhe Levulinat kalciumi dihidrat 572mg/10ml) të njëjtin funksion me atë të kërkuar nga ana e autoritetit (Calcium gluconate, me formë – dozë 1 gr/10ml – 10 ml, njësia Flakon/Ampulë), pa ndryshuar karakteristikat e barit dhe **cenuar jetën dhe shëndetin e pacientëve?**

Pra, sa më sipër, gjykoj, se në thelb qëllimi i procedurës së prokurimit objekt-ankimi është nëse autoriteti kontraktor përfiton një bar me të njëjtat cilësi dhe karakteristika si ajo e kërkuar në specifikimet teknike dhe më tej nëse bari i ofertuar si pasojë e përmbajtjes së tij nuk sjell direkt apo indirekt pasoja negative në shëndetin e pacientëve që do të trajtohen, për këtë arsye mendimi i një eksperti të fushës do të ishte me rëndësi për zgjidhjen objektive të çështjes.

Theksoj, se një ndër parimet kryesore të marrjes së vendimeve të Komisionit të Prokurimit Publik është edhe parimi i kontradiktoritetit, parashikuar edhe në nenin 24 pika 3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar.

Parimi i kontradiktoritetit, i lidhur me atë të barazisë së armëve në proces, kërkon që secilës palë në gjykim t’i jepet një mundësi e arsyeshme për të paraqitur pretendimet e veta sipas kushteve, të cilat nuk e vendosin në disavantazh ndaj kundërshtarit. Secila palë duhet të ketë mundësi që të komentojë mbi të gjitha provat ose parashtrimet e paraqitura (*shih vendimet nr. 28, datë 22.05.2015; nr. 39, datë 18.07.2012; nr. 34, datë 25.07.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

Ndaj, vlerësoj, se në rastin në fjalë, do të duhet të ishte zbatuar i njëjti parim, i ndjekur edhe në vendimmarrjet e mëparshme të Komisionit.

**Kryetar**  
**Jonaid Myzyri**

